

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

aarapi@infosoftoffice.al

E-mail

Administrator Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/08/02

Data (viti/muaji/dita)

+355696407424

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-76125-07-26-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

2494416

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje Tonera

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/08/07

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/08/07

Numri i njoftimit

Kodi CPV

76125

30125120-8

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendim I KPP-së, Nr. 403 /2023, datë 22.05.2023

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Më datë 27.07.2023, në sistemin elektronik të prokurimeve (app.gov.al) të Agjencisë së Prokurimit Publik, është shpallur nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit “Procedure e hapur e thjeshtuar” me objekt: “Blerje tonera” me fond limit 2,494,416 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, me REF-76125-07-26-2023.

Në shtojcën 5 (Formulari i Specifikimeve Teknike) të DT-së është kërkuar:

Specifikimi i Materialeve: Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

NR	Emërtimi	Part Number	Njesia	Sasia
2	Brother HL L8260CDË -black cartidge (boje)	(TN431BK/TN433BK)	Copë	26
3	Brother HL L8260CDË - yelloë cartidge	(TN431Y/TN433Y)	Copë	21
4	Brother HL L8260CDË - magenta cartidge	(TN431M/TN433M)	Copë	21
5	Brother HL L8260CDË - cyan cartidge	(TN431C/TN433C)	Copë	21

1. [...Tonerat të jenë prodhim origjinal ose ekuivalent, jo të rimbushura, jo të ricikluara, të pahapura dhe me pullë sigurie. Kodi i tonerit përcakton dhe përputhet me tipin e printerit.

2. Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetin kontraktor, malli të shoqërohet me deklaratën e garancisë).

3. Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner) dhe të ketë pullën e sigurisë. Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako.

4. Në momentin e lëvrimit të mallit çdo produkt të ketë të etiketuar qartë prodhuesin, modelin/kodin e prodhuesit/part number.

5. Tonerat të jenë sipas standarteve të BE (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetin kontraktor, malli të shoqërohet me deklaratën e cilësisë dhe origjinën e tij).

II - Ambalazhimi

Mallrat duhet të dorëzohen të ambalazuara si më poshtë:

Tonerat të jenë të mbeshtjella në qese në menyre hermetike dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurtë) dhe të ambalazuara nëpër kuti, të shoqëruara këto me pulla sigurie nga prodhuesi. Tonerat duhet të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë dhe do të kryhet kontroll rigoroz për plotësimin e këtyre elementeve.

Duhet të lexohen me vëmendje rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t'u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.

Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

? Emri i produktit

? Emri i markës prodhuese

? Pulla e sigurisë

? Specifikimet e kërkuara.

....]

Në shtojcën 7 (Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit) të DT-së është kërkuar:
...2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Kodet e tonerave me të cilat merr pjesë në procedurë duhet të jenë të përshtatshme për rajonin tonë dhe të funksionojnë në pajisje..”.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.

Shoqëria “Infosoft Office” SHPK, si një kompani e fushës dhe e interesuar për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi, pasi u njoh me dokumentat e tenderit, vlerëson se, një pjesë e specifikimeve të mësipërme teknike dhe të kriterëve për kualifikim duhet të ndryshohen.

Për këto arsye, mbështetur në pikën 1 të nenin 110 (Afatet për ankim) të ligjit 162/2020 ”Për Prokurimin publik” ku përcaktohet se: “...1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë?.”, brenda afatit ligjor, po ju paraqesim ankesën si më poshtë vijon:

Ne nenin 36 (Specifikimet teknike) të LPP përcaktohet:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet?

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi OSE ORIGJINË APO PRODHIM SPECIFIK, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”?)

Në nenin 37 (Etiketat) të ligjit 162/2020”Për prokurimin public” në lidhje me etiketat përcaktohet:
“?1. Kur autoritetet ose entet kontraktore prokurojnë punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, ata mund të kërkojnë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kërkesat e etiketës përfshijnë vetëm kritere që lidhen me objektin e kontratës dhe janë të përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e punëve, furnizimeve ose shërbimeve që janë objekt i kontratës;

b) kërkesat e etiketës të bazohen mbi kritere objektivist të verifikueshme dhe jodiskriminuese;

c) etiketat të përcaktohen me një procedurë të hapur dhe transparente ku mund të marrin pjesë të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë organet qeveritare, konsumatorët, partnerët socialë, prodhuesit, shpërndarësit dhe organizatat joqeveritare;

ç) etiketat të jenë të aksesueshme për të gjitha palët e interesuara;

d) kërkesat e etiketës të përcaktohen nga një palë e tretë, mbi të cilën operatori ekonomik që aplikon për etiketën nuk mund të ushtrojë ndikim vendimtar.

Kur autoritetet ose entet kontraktore nuk kërkojnë që punët, furnizimet ose shërbimet të përmbushin të gjitha kërkesat e etiketës, ato tregojnë kërkesat e etiketës, të cilave u referohen. Autoritetet ose entet kontraktore, që kërkojnë një etiketë specifike, pranojnë të gjitha etiketat që konfirmojnë se punët, furnizimet ose shërbimet plotësojnë të gjitha kërkesat e barasvlershme të etiketës.

Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti ose enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti ose enti kontraktor.

2. Kur një etiketë përmbush kushtet e parashikuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1, por përcakton edhe kërkesa që nuk lidhen me objektin e kontratës, autoriteti ose enti kontraktor nuk e kërkon etiketën si të tillë, por mund të përcaktojë specifikimin teknik, duke iu referuar specifikimeve të detajuara të asaj etikete, ose, kur është e nevojshme, pjesëve të tyre, që lidhen me objektin e kontratës dhe janë të përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e këtij objekti?”

Në nenin 44 (Kërkesat e cilësisë) të VKM 285/2021, datë 19.05.2021”Për miratimin e rregullave të prokurimit public” parashikohet:

“?1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike

mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-së.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.

5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor..”.

I. Në lidhje me Specifikimet teknike të mëposhtme:

NR	Emërtimi	Part Number	Njesia	Sasia
2	Brother HL L8260CDË -black cartidge	(TN431BK/TN433BK)	Copë	26
3	Brother HL L8260CDË - yelloë cartidge	(TN431Y/TN433Y)	Copë	21
4	Brother HL L8260CDË - magenta cartidge	(TN431M/TN433M)	Copë	21
5	Brother HL L8260CDË - cyan cartidge	(TN431C/TN433C)	Copë	21

Se pari: Per artikujt e mesiperme rezulton se, autoriteti kontraktor ka percaktuar nga dy part number-a të ndryshem per secilin ze, ku per secilin artikull perfaqeson dy kapacitete te ndryshme. Ne momentin që bojrat kanë kapacitete të ndryshme printimi, rrjedhimisht jane dy artikuj te ndryshem, qe kane kosto te ndryshme (sa me i larte kapaciteti, aq me e larte kostoja) dhe nuk kosiderohen ekuivalent te njeri-tjetrit. Nuk mund te kerkoni ne nje ze dy artikuj te ndryshem, per kete arsye duhet te percaktoni vetem nje PN dhe ekuivalentin e tij, duke mbajtur ne konsiderate qe “ekuivalent” konsiderohet kur tonerat kane kapacitete te njejta printimi.

Se dyti: Ne piken 2.3.5 te Kapacitetit Teknik jeni shprehur qe : “?Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Kodet e tonerave me të cilat merr pjesë në procedurë duhet të jenë të përshtatshme për rajonin tonë dhe të funksionojnë në pajisje..”, nderkohe që, ne shtojcen 5 te specifikimeve teknike, PN-at e percaktuara nga ana juaj, janë per Ameriken, pra nuk jane per rajonin tone. Per rajonin tone part numberat janë: PN TN-421BK, TN-421Y, TN-421M, TN-421C ose TN-423BK, TN-423Y, TN-423M, TN-423C.

Kërkojme që të percaktoni vetem nje kapacitet për artikull dhe te pranoni PN-at e rajonit tone.

Për artikujt e mëposhtëm të percaktohet part numberi i sakte që ben per pajisjet tuaja e konkretisht:

NR	Emërtimi	Part Number	Njesia	Sasia	Kerkese per sakesim PN
1	Hp laser jet MFP 135 A - Toner Cartidge	HP 105A - (W1105A)	Copë	53	Part number-i (PN) i kerkuar nga ana juaj 105A - (W1105A) eshte PN Amerike. PN i rajonit tone eshte W1106A, i cili ben per pajisjen Hp laser jet MFP 135 A dhe eshte per te njejtin kapacitet printimi sa PN i kerkuar nga ana juaj. Kerkojme qe te pranoni edhe PN W1106A.

7 Xerox versalink B7100- Toner Cartidge (006R01818) Copë 32 PN i kerkuar nga ana juaj (006R01818), nuk perkon me PN e rajonit tone. PN i rajonit tone eshte 006R01819. Per modelet Xerox, ne rast se nuk merni PN e duhur, atëherë pajisja nuk e njih çipin dhe si rrjedhoje nuk punon. Ju lutemi konfirmoni PN qe ben per pajisjen tuaj.

15 Toner Xerox Phaser 3330/WorkCentre 3335/3345 (106R03622) Copë 16 PN i kerkuar nga ana juaj (106R03622), nuk perkon me PN e rajonit tone. PN i rajonit tone eshte 106R03621. Per modelet Xerox, ne rast se nuk merni kodin e duhur aëherë pajisja nuk e njih çipin dhe si rrjedhoje nuk punon. Ju lutemi konfirmoni PN qe ben per pajisjen tuaj.

Për sa më sipër, kërkohet të bëhen ndryshimet si më sipër me qëllim shmangien e konfuzionit gjate ofertimit dhe mosfunksionimit te bojrave gjatë zbatimit të kontratës.

I.2- Në lidhje me Specifikimet teknike të mëposhtme:

“...1. Tonerat të jenë prodhim origjinal ose ekuivalent, jo të rimbushura, jo të ricikluara, të pahapura dhe me pullë sigurie. Kodi i tonerit përcakton dhe përputhet me tipin e printerit.

2. Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me deklaratën e garancisë).

3. Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner) dhe të ketë pullën e sigurisë. Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako.

4. Në momentin e lëvrimit të mallit çdo produkt të ketë të etiketuar qartë prodhuesin, modelin/kodin e prodhuesit/part number.

5. Tonerat të jenë sipas standarteve të BE (në momentin e dorezimit të mallit tek autoritetet kontraktor, malli të shoqërohet me deklaratën e cilësisë dhe origjinën e tij).

II - Ambalazhimi

Mallrat duhet të dorëzohen të ambalazuara si më poshtë:

Tonerat të jenë të mbeshjtjella në qese në menyre hermetike dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurtë) dhe të ambalazuara nëpër kuti, të shoqëruara këto me pulla sigurie nga prodhuesi. Tonerat duhet të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë dhe do të kryhet kontroll rigoroz për plotësimin e këtyre elementeve.

Duhet të lexohen me vëmendje rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t'u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.

Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

- ? Emri i produktit
- ? Emri i markës prodhuese
- ? Pulla e sigurisë
- ? Specifikimet e kërkuara.

....” kërkohet të ndryshohen me argumententat si më poshtë:

Së pari:

Në pikë 1 të specifikimeve teknike autoriteti kontraktor ka kërkuar “...1. Tonerat të jenë prodhim origjinal ose ekuivalent, jo të rimbushura, jo të ricikluara, të pahapura dhe me pullë sigurie. Kodi i tonerit përcakton dhe përputhet me tipin e printerit?”

Përcaktimi që “?Kodi i tonerit përcakton dhe përputhet me tipin e printerit?” është kufizues dhe orienton drejt prodhuesve të pajisjeve dhe përcakton ne menyre indirekte marken e tonerit, pra vjen në kundërshtim me nenin 36 të LPP-së, pasi nuk lejon ofertimin me produkte ekuivalente, pra kufizon konkurrencën, pjemarrjen e operatorëve ekonomikë të cilët ofrojnë tonera origjinale, e jo te rimbushur, te prodhuar per te funksionuar/kompatibel me pajisjet qe autoriteti/enti kontraktor

disponon dhe sipas Product Number (PN), por te nje marke tjeter prodhuese nga ajo e pajisjeve te cilave do t'u sherbeje

Përveç sa më sipër ky specifikim teknik vjen në kundërshtim edhe me Rekomandiminin mbi hartimin e kriterëve për kualifikimin në procedurat e prokurimit për mallra, punë shërbime, të Agjencisë së Prokurimit Publik, të datës 24.12.2022, ku është rekomaduar si më poshtë vijon: “?12. Gjatë monitorimit të dokumenteve të tenderit, APP ka konstatuar raste kur AK u referohen në mënyrë direkte apo indirekte, të specifikimet teknike, apo të kërkesat për kualifikim, markave apo origjinave specifike për produktet apo shërbimet e kërkuara. P.sh, në procedurat e prokurimit me objekt blerje tonerash, AK përcaktojnë kërkesa që tonerat nuk do të jenë tonera kompatibel dhe duhet të jenë origjinale nga prodhuesi i printerit dhe fotokopjes.

Në lidhje me përcaktimet e mesipërme, sjellim në vëmendjen e autoriteteve/enteve kontraktore se duke specifikuar se bojrat duhet të jenë origjinale nga prodhuesi i printerit dhe fotokopjes si dhe nuk duhet të jenë kompatibel, apo që Kodi i tonerit përcakton dhe përputhet me tipin e printerit, ato përcaktojnë në mënyrë indirekte markën e tonerave apo/dhe të prodhuesit dhe kufizon pjesëmarrjen e ofertuesve, të cilët mund të ofrojnë tonera origjinale, me pulle sigurie e jo të rimbushur, të prodhuar për të funksionuar/kompatibel me pajisjet që autoriteti/enti kontraktor disponon dhe sipas Product Number (PN), por të një marke tjeter prodhuese nga ajo e pajisjeve të cilave do t'u shërbeje, APP sugjeron shmangien e përcaktimeve të tilla, apo riformulimin e kërkesave, duke u mjaftuar me përcaktimin që toneri të jetë i përshtatshëm për tipin e printerit?”

PËR SA MË SIPËR, KËRKOJMË QË NË PIKËN “1. Tonerat të jenë prodhim origjinal ose ekuivalent, jo të rimbushura, jo të ricikluara, të pahapura dhe me pullë sigurie. Kodi i tonerit përcakton dhe përputhet me tipin e printerit”, të hiqet specifikimi teknik që “Kodi i tonerit përcakton dhe përputhet me tipin e printerit..”.

Së dyti: në lidhje me specifikimin teknik “?2. Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me deklaratën e garancisë)..” kërkojmë ndryshimin e këtij kriteri me argumentat si më poshtë vijojnë:

- Jo të gjithë tonerat kanë afat skadence e konkretisht, vetëm tonerat likuidë, pra që janë të lëngshme mund të skadojnë dhe jo ato që janë me bazë pluhuri. Konkretisht tonerat për lazer dhe për fotokopje nuk skadojnë pasi janë me bazë pluhuri, kurse tonerat për printerat inkjet kanë afat skadence sepse këto lloj bojrash janë të lëngshme dhe me kalimin e kohës ato thahen, pra skadojnë. Vetëm për këto lloj bojrash ka kuptim afati i skadencës.

Me qëllim shmangien e interpretimeve të ndryshme në lidhje me këtë kërkesë, gjatë vlerësimit të ofertave, apo edhe gjatë zbatimit të kontratës, ku strukturat e ngritura nga AK-ja për të marrë në dorëzim mallrat objekt prokurimi, nisur nga kjo kërkesë në specifikimet teknike mund të kërkojnë që në ambalazhet e tonerave të jete i përcaktuar detyrimisht edhe afati i skadencës për të gjithë tonerat, kërkojmë që kjo kërkesë të modifikohet. Në rastin konkret referuar listës së artikujve të tonerave të kërkuara nga AK-ja, rezultojnë se pothuajse të gjitha modelet e kërkuara, nuk kanë afat skadence, pasi ata nuk janë tonera me bojë “inkjet”, pra me boje likuide..

PËR KËTË QËLLIM, KËRKOJMË TË NDRYSHOHET KY SPECIFIKIM TEKNIK duke shtuar edhe përcaktimin .”për tonerat të cilat kanë afat skadence”, pra specifikimi teknik të jetë si më poshtë:

“?2. Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me deklaratën e

garancisë (për tonerat të cilat kanë afat skandence)..”

Ne shtojcen 5 ne DT, kerkohet si me poshte:

II - Ambalazhimi

Mallrat duhet të dorëzohen të ambalazuara si më poshtë:

Tonerat të jenë të mbështjella në qese në menyrë hermetike dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurtë) dhe të ambalazuara nëpër kuti, të shoqëruara këto me pulla sigurie nga prodhuesi. Tonerat duhet të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë dhe do të kryhet kontroll rigoroz për plotësimin e këtyre elementeve.

Duhet të lexohen me vëmendje rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t’u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.

Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:

Emri i produktit

Emri i markës prodhuese

Pulla e sigurisë

Specifikimet e kërkuara.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën në çdo kohë të bëjë çdo verifikim për origjinalitetin e produkteve të ofruar

Të gjitha këto kërkesa, kanë lidhje vetëm me pamjen e jashtme të produktit dhe nuk kanë asnjë ndikim në funksionalitetin e tij. Është tërësisht jashtë mundësive të OE, të ndikojnë tek prodhuesit e artikujve, në mënyrën sesi do të ambalazhojnë produktet e tyre.

Për AK është e rëndësishme që informacionet e kërkuara si emri i produktit, emri i markës prodhuese, pulla e sigurisë dhe specifikimet teknike, të jenë të pasqyruara në produkt, pavarësisht nëse janë në etiketë, apo të printuara në ambalazh, apo në trup të tij.

Per me teper qe pulla e sigurise (ne rastet kur aplikohet nga prodhuesit), nuk vendoset mbi etikete, por ne kuti .

Sqarojmë gjithashtu se, tonerat nuk klasifikohen tek produktet që kanë në përbërjen e tyre elementë të rrezikshëm e që për pasojë në etiketa apo në ambalazh të përcaktohen detyrimisht masat mbrojtëse ndaj këtyre elementëve.

Ne si tregëtues të tonerave nuk mund të detyrojmë prodhuesit të vendosin të dhëna të tilla në paketim, tek etiketat apo në trupin e bojës. Prandaj këto kërkesa dalin jashtë kompetencave tona. Autoriteti juaj kontraktor nuk mund të vendosë një kërkesë apo të vlerësojë një ofertues për kritere që nuk janë as kompetence, as e drejte e jona si OE. Per me teper që këto elemente, nuk janë nga ato elemente të cilët përcaktohen si të detyrueshem nga ndonje standart i aprovuar cilesie, në mënyrë që të garantojë cilësi të produktit. Këto elemente, nuk ndikojnë në cilësinë apo në funksionalitetin e tonerit dhe për pasojë prezenca apo mungesa e tyre, sic kërkohet nga ana juaj, nuk jep asnjë garanci që produkti do të jetë me funksional apo me cilësor.

Rrjedhimisht kërkojmë që të hiqet kërkesa që : “Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat ?”

Ne Vendimin Nr. 787/2021 KPP është shprehur si më poshtë:

“KPP gjykon se me anë të kërkesës së mësipërme, autoriteti kontraktor kërkon nga ana e operatorëve ekonomikë vendosjen e etiketës me qëllim që të jenë lehtësisht të verifikueshme të dhënat teknike të produkteve të ofruara të dhëna që lidhen me emrin e produktit, markën prodhuese, specifikimet teknike të kërkuara, treguesit fiziko kimik, të cilat në thelb vërtetojnë përputhshmërinë e produktit objekt prokurimi me kërkesat e autoritetit kontraktor. Por, Komisioni gjykon se mënyra si pasqyrohen të dhënat e produktit është në diskrecion të vetë prodhuesit dhe jo të ofertuesve pjesëmarrës në procedurë. Komisioni thekson se për autoritetin kontraktor duhet të jetë e rëndësishme të sigurohet që produktet e ofruara plotësojnë specifikimet teknike dhe jo ku pasqyrohen ato. Prodhues të ndryshëm, elementët e kërkuar lidhur me produktin, mund ti kenë të pasqyruara në trupin e produktit dhe jo domosdoshmërisht në ambalazhin e tyre. Në këto kushte,

Komisioni gjykon se vendosja e etiketës mbi kuti apo mbi produkt nuk është kusht skualifikues, pasi qëllimi përfundimtar i këtij kriteri është njohja e të dhënave të produktit?”.

Ne shtojcën 5 ne DT, kërkohej si me poshte:

3. Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner) dhe të ketë pullën e sigurisë. Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako.

Psh kërkesa që, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako është një kërkesë e cila nuk është në dorën e operatorit ekonomik, por është një zgjedhje dhe vendim i prodhuesit i cili vendos nëse, do të vendosë numrin serial të artikullit konkret në trupin e tonerit apo në ambalazh, apo jo. Kjo kërkesë është e panevojshme sepse vendosja ose jo e numrit serial nuk sjell asnjë ndikim në lidhje me sigurinë apo cilësinë e produktit, pasi në vetvete numrat seriale janë thjesht numra që lidhen me menyren organizative të produkteve, të prodhuesve. Nga eksperiencia jonë e gjatë në treg, janë të paktë ata prodhues të cilët i vendosin numrat seriale të produktit në ambalazh, apo në trupin e tonerit.

Pra një kërkesë e tillë sjell kufizim dhe përjashtim nga pjesmarrja në tender.

Synimi i AK-së është të sigurojë tonera të cilët janë cilësore dhe përshtaten me pajisjet dhe fakti se, janë vendosur ose jo numrat seriale në tonera, nuk sjell asgjë të re përsa i përket cilësisë së produktit, pra të tonerit.

NISUR SA MË SIPËR, NE KËRKOJMË QË TË MODIFIKOHET SPECIFIKIMI TEKNIK në pikën 3 të shtojcës 5 të DT-së përcaktimi: “?numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako (Ne rastet kur aplikohet nga prodhuesi).”

Në zbatim të nenit 21 të LPP-së, autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në nenin 36 (Specifikimet teknike) të LPP-së, ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë të qartë elementët të cilët duhet të pasqyrohen në specifikimet teknike të objektit të prokurimit, dhe që është në detyrimin e autoritetit kontraktor që në hartimin e specifikimeve teknike të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Sa më sipër, në vlerësimin tonë, vendosja e specifikimit teknik që, në trupin e bojës të jetë i stampuar emri i prodhuesit, jo vetëm që është e një kërkesë e ekzagjeruar, por mbi të gjitha është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit public pasi:

- Kërkesa të tilla për tu plotësuar, nuk varet nga vullneti i operatorit ekonomik;
- nuk janë të detyrueshme për tu zbatuar nga prodhuesi pra për tu aplikuar, referuar rregullave teknike të prodhimit për këto lloj produktesh;
- nuk ka snjë argument nga AK-ja në procesverbalin e hartimit të dokumentave që, përse janë të rëndësishme dhe si lidhen këto kërkesa në specifikimet teknike, me arritjen e synimit të ligjshëm të autoritetit kontraktor në lidhje me cilësinë e tonerave, pra përse është e detyrueshme plotësimi nga OE-të i këtyre specifikimeve teknike, çfarë vërtetohet me anë të këtyre specifikimeve teknike??. ndërkohë që për të verifikuar nëse tonerat e ofertuara përshtaten me pajisjet e autoritetit

kontraktor verifikohet nëpërmjet kodit kush është prodhuesi është lehtësisht e verifikueshme në ambalazhin e tonerit.

Për pasojë kjo kërkesë, penalizon në mënyrë të paligjshme pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë pasi, pamundëson pjesmarrjen e tyre në procedurën e prokurimit, pra sjell një trajtim të pabarabartë për të gjithë ofertuesit dhe shërben si pengesë për konkurrencën e hapur në prokurimin public, pasi favorizon vetëm atë prodhues të cilët e aplikojnë stampimin e emrit të tyre në trupin e tonerit.

Synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës dhe në rastin konkret në dokumentat e tenderit e konkretisht në shtojcën 6 (formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimin) të DT-së për të gjithë artikujt e tonerave të kërkuar, autoriteti kontraktor ka përcaktuar për cdo lloj toneri plotësimin e specifikimeve teknike si më poshtë;

- emertimi i tonerit ku përcaktohet edhe kodi I tij i cili është edhe elementi kryesor me anë të të cilit verifikohet nga AK nëse, toneri i ofertuar i përshtatet pajisjes për të cilin kërkohet, pra modelit të pajisjes. Pra, synimi i ligjshëm i autoritetit kontraktor është të sigurojë tonera për pajisjet të cilat ai vetë ka përcaktuar në DT dhe që këto tonera të arrijnë të printojnë një numër të caktuar fletësh. Për pasojë fakti nëse, në trupin e tonerit do të vendoset apo jo pulla e sigurisë, që numrat serialë të tonerave të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako, që ambalazhi i tonerave të jetë I mbeshjtjelle në qese në menyrë hermetike?..të shoqëruara këto me pulla sigurie nga prodhuesi, që në etiketën e tonerit të vendoset pulla e sigurisë, specifikimet e kërkuara, janë kërkesa të ekzagjeruar, të paargumentuara, jo në përputhje me objektin dhe vlerën e kontratës, e pamundur për tu realizuar, kufizon pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe në cdo rast nuk i shërben synimit të ligjshëm të autoritetit kontraktor.

Per me teper ju sjellim ne vemendje se pulla e sigurise, apo fakti se ambalazhi I tonerit duhet në qese në menyrë hermetike, apo vendosja e pullave në ambalazh apo ne etiketen e produktit, nuk janë elemente të cilat përcaktohet si të detyrueshem nga ndonje standart i aprovuar cilesie, në mënyrë qe te garantoje cilesi te produktit. Këto elemente, nuk ndikojnë në cilësinë apo në funksionalitetin e tonera dhe për pasojë prezenca e tyre, nuk jep asnjë garanci që produkti do të jetë me funksional apo me cilësor. Ka raste për më tepër që, prodhues te paisjeve, kane zgjedhur të mos aplikojnë ndonje pulle sigurie per tonerat e prodhuar prej tyre, si p.sh Toshiba, Xerox për një pjesë modele tonerash.

Në lidhje me kërkesën që, “..Tonerat të jenë të mbeshjtjella në qese në menyrë hermetike”

GJYKUAR SA ME SIPER, KËRKOJMË ndryshimin e specifikimeve teknike si më poshtë, duke shtuar togfjaleshin “në rastet kur aplikohet nga prodhuesi” e konkretisht si më poshtë:

- “...Tonerat të jenë prodhim origjinal ose ekuivalent, jo të rimbushura, jo të ricikluara, të pahapura dhe me pullë sigurie“në rastet kur aplikohet nga prodhuesi”;

- “Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner) dhe të ketë pullën e sigurisë. Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako (në rastet kur aplikohet nga prodhuesi);

- “Tonerat të jenë të mbeshjtjella në qese në menyrë hermetike (në rastet kur aplikohet nga prodhuesi) dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurtë) dhe të ambalazuara nëpër kuti, të shoqëruara këto me pulla sigurie nga prodhuesi (në rastet kur aplikohet nga prodhuesi); Tonerat duhet të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë dhe do të kryhet kontroll rigoroz për plotësimin e këtyre elementeve?”

Pasi, ne menyren se si janë kerkuar nga ana juaj, perjashtohet nje numer I konsiderueshem prodhuesish, te cilet kane standartet e tyre te ambalazhimit, te ndryshme nga kërkesat e përcaktuara

nga ju, por gjithnjë, duke plotësuar të gjitha kërkesat dhe standartet e cilesise.

Komisioni i Prokurimit Publik mbi këtë kriter është shprehur në një sërë vendimesh të tij. Ju sjellim ne vemendje Vendimin Nr. 325/2020, ku KPP arsyeton se, “?AK nuk mund të hartojë të tilla kërkesa ku plotësimi i kërkesave nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomik pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave teknike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme nuk është e përshtatshme për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përpunueshmërisë së produkteve, kjo pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomik pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e oferteve teknike në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor... Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor..”.

Komisioni I Prokurimit Publik së fundmi me vendimin e tij Nr. 563/2023, datë 05.07.2023, pas shqyrtimit të një ankesë e cila kishte për objekt edhe kundërshtimin e pullave të sigurisë në ambalazhin e produktit, ka arsyetuar si më poshtë vijon:”? Sa më sipër në interpretim të nenit 44 pika 2, të VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KPP gjykon se me anë të kërkesës së mësipërme, autoritetit kontraktor kërkon nga ana e operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dokumentacion provues në të cilin të jenë lehtësisht të verifikueshme të dhënat teknike të produkteve të ofruara të dhëna që lidhen me emrin e produktit, markën prodhuese, pullën e sigurisë, specifikimet teknike të kërkuara, treguesit fiziko kimik të cilat në thelb vërtetojnë përputhshmërinë e tyre me kërkesat e autoritetit kontraktor mbi mallin. Në rastin konkret autoriteti kontraktor ka kërkuar që etiketa me elementët përkatëse të jetë e stampuar mbi ambalazhin e produktit. Me të drejtë ankimuesit kundërshtojnë këtë kërkesë, pasi mënyra si pasqyrohen të dhënat e produktit, sikundër kërkuar në kriterin e veçantë të kualifikimit, është në diskrecion të vetë prodhuesit dhe jo të ofertuesve pjesëmarrës në procedurë. Kërkesa që etiketa të jetë në ambalazhin e produktit, kufizon ata prodhues që elementët e kërkuar lidhur me produktin mund t’i kenë të pasqyruara në trupin e produktit dhe jo domosdoshmërisht në 11 ambalazhin e tyre. Akoma më tej edhe vetë autoriteti kontraktor në kthim-përgjigjen drejtuar ankimuesve ka pranuar, se vendosja mbi kuti apo mbi produkt nuk është kusht skualifikues, pasi qëllimi përfundimtar i këtij kriteri është njohja e të dhënave të produktit, por në përfundim ka vendosur mospranimin e kërkesës së ankimuesve për modifikimin e kriterit. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kërkesën që tonerat të jenë të pajisur me pullë sigurie, duke lënë të hapur mundësinë e vendosjes së pullës së sigurisë, pasi pajisja e tonerave më pulla sigurie nuk varet nga ofertuesit por nga prodhuesit të cilët jo të gjithë e kanë politikë të tyre pajisjen e tonerave me pulla sigurie, fakt i cili pranohet dhe nga ana e autoritetit kontraktor në kthimin e përgjigjes. Modifikimi i kërkesës së mësipërme objekt-shqyrtimi është i nevojshëm, pasi në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e mësipërme nuk është e përshtatshme për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përpunueshmërisë së produkteve, kjo pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme nuk varet nga vullneti i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave teknike në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor. Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.?”

Në vendimet e saj KPP-ja shpesh e ka vënë në dukje faktin se, vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve

ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, por pa përcaktuar kërkesa të cilat krijojnë konfuzion apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

Për gjithë sa më sipër argumentuam, kërkojmë ndryshimin e specifikimeve teknike sipas arsytimit dhe argumentimeve të mësipërme, si kërkesa të ekzagjerura, të pamundura për tu plotësuar, kufizuese për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, nuk janë proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor, pra nuk janë në përputhje me ligjin e prokurimit publik, dhe për më tepër të paargumentuara nga autoriteti kontraktor.

Të nderuar,

Në nenin 2 (Qëllimi) të ligjit 162/2020, përcaktohet si vijon:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 (Parime të përgjithshme) të ligjit 162/2020, përcaktohet si vijon:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar”.

Pretendimet dhe kërkesat tona janë në përputhje të plotë me qëllimin e ligjit dhe me parimet e përcaktuara më sipër në legjislacionin e prokurimit publik dhe për më tepër nxitin dhe rrisin numrin dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit public, duke sjellë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

nuk ka

7. Lista e informacionit konfidencial:

nuk ka

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

aarapi@infosoftoffice.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Frederik Prodani